



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

PROJEKTLIGJ

Nr. _____, datë _____.____.

**PËR
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9270, datë 29.7.2004
“PËR SISTEMIN E ADRESAVE”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 9270, datë 29.7.2004, “Për sistemin e adresave”, i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 2 bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë, vijojnë:

1. Në shkronjën d), të pikës 1, hiqet togfjalëshi “*bulevardit/rrugës/rrugicës/parkut ose sheshit*”.
2. Në pikën 1, shtohet shkronja “f”, si më poshtë, vijon:
“f) kodi unik i adresës, i cili identifikon në mënyrë unike vendndodhjen e çdo ndërtese apo trualli të lirë, në shkallë vendi”.
3. Shtohet pika 3, si më poshtë, vijon:
“3. Mënyra e kodimit dhe struktura e kodit unik të adresës përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave”.

Neni 2

Në nenin 33/1 shtohet pika 3, si më poshtë, vijon:

1. “3. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë vendim, në zbatim të nenit 2, pika 3, të këtij ligji”.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
LINDITA NIKOLLA**